

VENDIM
Nr.25, datë 20.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH’”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 25, datë 20.8.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje për objekt të rëndësisë së veçantë nr. 49 , Reparti ushtarak nr. 3205, Vlorë, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, procesverbale asgjësimi të dokumenteve të repartit ushtarak 3205 Vlorë, datë, datojnë në vitin 1991, me 22 (njëzetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje për objekt të rëndësisë së veçantë nr. 1069, për repartin ushtarak 8795 Orikum, dy volume, me 23 (njëzetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, Libri i Evidencës të punëtorit operativ të Sigurimit të Ushtrisë, me 100 (një qind) fletë. Dosja daton në 1988-n. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje formulare nr. 4638, në ngarkim të Xh. B, me 480 (katërqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje formulare nr. 1782, në ngarkim të F. K, me 354 (treqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje përpunimi nr. 89, në ngarkim të A. A, me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje përpunimi nr. 3182, në ngarkim të M. K, me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pukë, dosje formulare nr. 618, në ngarkim të Gj. H, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje përpunimi nr. 397, në ngarkim të S. H, me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Veçantë, Fashikulli Agjenti, “Alfredi” në ngarkim të J. Ll, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mat, dosje pune dhe personale nr. 2932, në ngarkim të P. A, me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje formulare nr. 289, si dhe dosje hetuesie, në ngarkim të J. Ll, me 461 (katërqind e gjashtëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula